



Npi – 01/37 datë: 05.03.2026

Duke u bazuar në nenin 12 pika (d) nenin, 17 pika (f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 5.2 dhe 8.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087; Ligjin Nr.04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike; Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më: 05.03.2026, miratoi:

**V E N D I M**  
**PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR K.R.M.**  
**“PASTËRTIA” SH.A - NJËSIA NË SHTIME**

I

**Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e parë për vitin 2026, të mbajtur më: 05.03.2026, me shumicën e votave miratoi, Vendimin për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A - Njësia në Shtime.**

II

Komisioni Komunal i Aksionarëve, për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia”- SH.A, njësia në Shtime, në përputhje me nenin 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087, do t’i ketë 3(tre) anëtar: 1(një) anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtar të zgjedhur nga Kuvendi.

III

Përbërja e Komisionit Komunal të Aksionarëve, është si vijon:

1. z.Faruk Beqa (i emëruar nga Kryetari i Komunës),
2. znj.Albana Fazliu (e zgjedhur nga Kuvendi),
3. znj.Rrezarta Ramadani (e zgjedhur nga Kuvendi).

IV

4.1 Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

4.2 Komisioni Komunal i Aksionarëve i raporton Kuvendit të Komunës në bazë vjetore.

4.3 Mandati i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve zgjatë aq sa zgjatë mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Shtimes.

4.4 Kuvendi i Komunës së Shtimes e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të Komisionit kur do herë që kërkohet.

III

Vendimi hynë në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komisionit, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Drejtorive, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Rrahman Jakupi